



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 54 , Datë 29.03.2022

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “IRARBA ENERGJI” SH.P.K .PËR TRANSFERIMIN E
ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË (UNITED BANK
OF ALBANIA) SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neni 67 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; si dhe neni 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 406/4 prot., datë 25.03.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. për transferimin e asetëve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a.”,

Konstatohet se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1012 prot., datë 18.10.2021, shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për vendosje hipoteke dhe barrë siguroese/peng të asetëve në favor të Bankës së Bashkuar të Shoqërisë (United Bank of Albania sh.a.).
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 21.01.2022, vendosi zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë pune të afatit të vendimmarrjes mbi kërkesën e shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. për transferimin e asetëve në favor të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (United Bank of Albania) sh.a., duke filluar ky afat nga data 12.02.2022.
- Në vijim shoqëria ka depozituar një aplikim për financim biznesi të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë protokolluar në ERE me nr. 194/1 prot., datë 08.02.2022, për një periudhë 7-vjecare.
- Për sa depozituar nga shoqëria, ERE iu drejtua Bankës me shkresën nr. 194/2 prot., datë 21.02.2022, duke i kërkuar që të informojë ERE-n nëse është nënshkruar kontrata përkatëse e kredisë referuar aplikimit të shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k. për financim, e nëse kontrata është nënshkruar, depozitimin e saj në ERE, së bashku me listën përkatëse të asetëve që vendosen si mjete për garantimin e detyrimit që lind nga kjo kontratë. Nga Banka nuk ka pasur kthim përgjigjeje, ndaj ERE për arsye të sigurisë së disponimit të shkresës, vlerësoi ridërgimin e shkresës, me e-mail në datën 25.03.2022.

- Duke qenë se në dokumentacionin e depozituar nga subjekti në kuadër të këtij aplikimi nuk është e qartë natyra e marrëveshjes/marrëveshjeve me bankën mbi këtë transferim dhe me qëllim rakordimin e listës së asetëve, duke e vlerësuar si një dokument thelbësor për vendimmarrjen për dhënien e autorizimit për transferimin e këtyre asetëve, në mbështetje të nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe referuar përcaktimeve të nenit 10, pika 1 dhe 2, të “Rregullores së procedurave për transferimin e asetëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016, vlerësohet zgjatja me 30 (tridhjetë) ditë pune e afatit për depozitimin e dokumentacionit/informacionit nga shoqëria ose banka, në lidhje me nënshkrimin e kontratës përkatëse të kredisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë pune afatin për depozitimin e dokumentacionit/informacionit nga shoqëria “IRARAB ENERGJI” sh.p.k., ose Banka e Bashkuar e Shqipërisë (United Bank of Albania sh.a.) në lidhje me nënshkrimin e kontratës përkatëse të kredisë.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI